

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **KOMUNA GLOGOC**

Për Aktivitetin e Prokurimit - Nr. i AP: **611-26-1738-5-2-1**

Sa i përket tenderit për: **NDERTIMI I FUSHAVE SPORTIVE KOMORAN ,KORRETICË E EPËRME DHE ARLLAT Projekt dyvjeçar**

### A N K E S Ë

**Identifikimi i ankuesit\***

**TREING SH.P.K.**

*(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)*

**Rr. Dëshmorët e Ponoshecit nr. 69**

*(Adresa)*

**Prishtinë**

*(Vendi)*

**10000**

*(Kodi postar)*

**+383 49293969**

*(Numri Telefonit)*

*(Numri i Faks-it)*

**Uljan Thaçi**

*(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)*

**3ingshpk@gmail.com**

*(Adresa elektronike)*

**25.04.2026**

*(Data e parashtrimit të ankesës)*



*(Nënshkrimi dhe vula)*

\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

## 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimin të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

## 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

*[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës].*

Ky aktivitet i prokurimit ka filluar me njoftimin për kontrate me datë 30.03.2026.

Hapja e tenderëve është paraparë për tu bërë me datë 20.04.2026 por tash pas Kërkesës për Rishqyrtim është shtyrë deri më 27.04.2026.

Të pakënaqur me disa nga kriteret dhe kërkesat të dosjes së tenderit me datë 14.04.2026 jemi drejtuar me Kërkesë për Rishqyrtim tek Autoriteti Kontraktues.

AK me date 15.04.2026 e ka refuzua kërkesën tone andaj te pakënaqur me këtë vendim po i drejtohem OSHP-se me ankesë.

Kriteri i vlerësimit ka qenë Tenderi i përgjegjshëm me **Çmimin më të ulët.**

#### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

Po

Jo

Hapja e tenderëve nuk është bërë akoma. Është caktuar të bëhet me datë 20.04.2026 por tash pas Kërkesës për Rishqyrtim është shtyrë deri më 27.04.2026.

#### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

Po

Jo

#### 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

*A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

Po

Jo

Ky aktivitet i prokurimit ka filluar me njoftimin për kontrate me datë 30.03.2026.

Hapja e tenderëve është paraparë për tu bërë me datë 20.04.2026 por tash pas Kërkesës për Rishqyrtim është shtyrë deri më 27.04.2026.

Të pakënaqur me disa nga kriteret dhe kërkesat të dosjes së tenderit me datë 14.04.2026 jemi drejtuar me Kërkesë për Rishqyrtim tek Autoriteti Kontraktues.

AK me date 15.04.2026 e ka refuzua kërkesën tone andaj te pakënaqur me këtë vendim po i drejtohem i OSHP-se me ankesë.

#### 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit,*

*dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

**AK ka shkelur nenin 1 dhe 6 të LPP Nr. 04/L-042;**

**AK ka shkelur nenin 7 të LPP Nr. 04/L-042;**

**AK ka shkelur nenin 27 të LPP Nr. 04/L-042;**

**AK ka shkelur nenin 69 të LPP Nr. 04/L-042;**

**AK ka shkelur nenin 17 të RRPP-001/2022;**

## **8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së.*

*Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

**Pretendimi 1.** AK ka shkelur nenin 7 të LPP-se pasi që gjatë hartimit të dosjes së tenderit përkatësisht gjatë parashtrimit të kriterëve dhe kërkesave për OE, ka vendosur kufizime strikte që sipas tyre shihet se ia ka përshtatur ekskluzivisht një OE të caktuar. Ky kriter përpos që shkakton kufizime të panevojshme tek OE, i njëjti është në kundërshtim të plotë me LPP-në dhe RRPP-001/2022. Vendosja e kufizimeve tek përvoja e kompanisë dhe tek stafi duke kërkuar referenca nga natyra e njëjtë si dhe certifikime të panevojshme dhe shumë të vjetra, duke mos lënë si mundësi për plotësimin e tyre me certifikata dhe diploma më të avancuara shkakton kufizim enorm të konkurrencës. Përpos kësaj edhe vendosja e specifikimeve tepër precize të pajisjeve të punës që shpesh janë të panevojshme dhe nuk ofrojnë as mundësi funksionale, e rritë edhe më shumë kufizimin e konkurrencës që sipas kësaj mundet vetëm një OE i caktuar të aplikoj. Kjo shihet se këtu mund të aplikoj vetëm ai OE që AK ia ka përgatitur tenderin në fjalë!. Ky veprim i AK-së bie plotësisht ndesh me nenin 7 të LPP-së si dhe bie ndesh edhe me nenin 27 dhe 69 të LPP-së që flasin për procedurat e prokurimit për punë, e posaçërisht bie ndesh me nenin 17 dhe 25 të RRPP-001/2022 të cilët kërkojnë që kërkesat e dosjes së tenderit duhet të jenë proporcionale me natyrën, llojin dhe madhësinë e projektit.

LPP dhe rregullorja e përcaktojnë qartë që kriteret dhe kërkesat që duhet të plotësohen nga OE nuk duhet krijojnë kufizime të panevojshme tek tenderuesit e sidomos ndalohet që përmes tyre të favorizohet ndonjë OE i caktuar siç ka vepruar AK me këtë tender. Vlen të ceket se edhe vitin e kaluar në një projekt të ngjashëm AK ka aplikuar kërkesa të tilla por rezultati i tenderit ka qenë me pjesëmarrjen e vetëm një tenderuesi. Pra mjafton të shihet tenderi që e kemi bashkangjitur si dëshmi dhe do të bindeni se kriteret dhe kërkesat e tilla janë shumë kufizuese për tenderuesit tjerë dhe se i përshtaten vetëm një OE të caktuar. Përpos krejt kësaj, krejt kjo konsiderohet edhe keq menaxhim i madh i parasë publike pasi që disa nga kriteret duken qartë si të panevojshme dhe se ato vetëm sa e rrisin çmimin e ofertave, që si veprim bie plotësisht ndesh me **nenin 1, 6 dhe 7 të LPP-së.**

**Pretendimi 2.** AK ka shkelur nenin 27 të LPP-së si dhe nenin 17 të RRPP-001/2022 me rastin e hartimit të dosjes së tenderit sepse kërkesat e vendosura tek FDT pika 9.1&9.2 nuk janë fare në përputhje me frymën dhe parimin e drejtë të prokurimit si dhe nuk i kontribuojnë aspak rritjes dhe promovimit së konkurrencës. Vet fakti që AK ka vendosur kritere shumë strikte tek lloji i referencave për punët e kryera, tek kriteret kualifikuese për persona me certifikime tepër të rralla, tek kriteret kualifikuese për përvoja shumë të gjata me (10 e 15 vite) dhe tek kriteret kualifikuese për pajisje dhe mjete tepër unike dhe të vjetra që nuk hyjnë fare në punë gjatë realizimit të projektit, tregon se kriteret e tilla janë shumë vështirë të i plotësoj një OE. E themi këtë pasi janë shumë vështirë të sigurohen si dhe janë kritere tepër të kushtueshme për OE. Pra krejt kjo tregon se hartimi i dosjes është bërë në kundërshtim të plotë me ligjin përkatësisht në kundërshtim me nenin 27 të LPP-së dhe në kundërshtim me nenin 17 të RRPP-001/2022.

Ja si e përshkruan neni 17.17 i RRPP-së detyrimin e AK-së për hartim të mirëfilltë të dosjes së tenderit:

**17.17 Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk:**

- a. Kufizon konkurrencën në mesin e OE, ose
- b. Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE.

Dosja e tenderit që AK e ka krijuar i ka shkelur të dyja këto parime të rregullores andaj s'kemi se si të mendojmë ndryshe përveç se AK e ka shkelur dispozitën në fjalë. Në vazhdim po i cekim dhe po i zërthejmë më detalisht kriteret që AK i ka lënë si elemente tejet kufizuese dhe si kërkesa që janë në kundërshtim të plotë me ligjin dhe parimet e drejta të prokurimit.

**Shkelja e parë në hartimin e dosjes së tenderit** - AK fillimisht e ka shkelur nenin 69 të LPP-së kur ka vendosur kriterin për përvojën e kompanisë duke kërkuar referenca për projekte tepër të njëjta me atë që do të realizohet. Ja si duket kërkesa që ne mendojmë se është tepër kufizuese:

|           |   |   |
|-----------|---|---|
| 9.1 & 9.2 | <p><b>Kapaciteti teknik dhe profesional:</b></p> <p><b>1.Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka realizuar me sukses kontrata te natyres se njeite (Ndertimi I fushes me bari sintetik)ne tri vitet e shkuara nga data e pubikimit te njoftimit per kontrate. ne vlerë prej jo më pak se 350,000.00 euro.</b></p> | <p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare</i></p> <p><b>Deshmia 1.Lista e kontratave emer dhe numer te këti aktivitetit të prokurimit të realizuara në tri vitet e shkuara nga data e publikimit te njoftimit për kontrate duhet të dorzohet e skenuar origjinale të jete e nënshkruar dhe e vulosur nga OE. Duke specifikuar emrin e projektit,shumën e kontrates,daten e fillimit dhe të mbarimit të kontrates dhe referenca apo raporte të pranimit teknik. Referencat apo raportet e pranimit teknik duhet të korresponojne në listen e kontratave.</b></p> |
|-----------|---|---|

Të kërkos referenca në vlerë 350,000.00€ (1.5 herë sa vlera e projektit) vetëm në ndërtim të fushave me bari sintetik është kulmi i kufizimeve. Paramendo këtu i ndalohet dhe i pamundësohet tenderimi edhe kompanisë që e ka ndërruar komplet fushën e Stadiumit të Prishtinës me vlerë milionëshe e lëre më kompanive tjera. Pra si kriter është tepër kufizues

dhe si i tillë duhet përgjithësohet me referencë në realizim të kontratave të ngjashme e jo të jetë referencë në realizim të projekteve të njëjta dhe me theks të veçantë **“ndërtimi i fushës me bari sintetik”**. Arsyeja tjetër pse e themi këtë është edhe fakti që pjesëmarrja e barit sintetik në tërë projektin është maksimum (5-7)% sepse nga natyra e punës dihet që tërë projekti përfshi edhe fusha bëhet ngjashëm sikur se tek fushat tjera sportive, vetëm se për dallim që këtu mungon ujitja dhe në vend të barit natyral apo tepisonëve të ndryshëm, vendoset bari sintetik. Pra po shihet se kriteri i tillë e kufizon shumë konkurrencën me kërkesën për projekte të NJËJTA (**ndërtimi i fushës me bari sintetik**) në vend se të jetë kërkesa për projekte të NGJASHME. Me që përqindja e pjesëmarrjes së barit sintetik në projekt është tepër e vogël dhe vendosja e tij nuk kërkon shumë profesionalizëm, atëherë s’është e nevojshme fare aplikimi i kriterit të tillë kaq të ngushtë. Se kjo kërkesë është kufizim enorm i konkurrencës e ka sqaruar edhe OPINIONI i KRPP-së me nr. 11 i datës 09.06.2023, i cili shumë qartë e thotë se aplikimi i kriterit për referenca nga **natyra e njëjtë është e ndaluar**. Ja si duket ky opinion i KRPP:

**11. 09.06.2023 Cili është përkufizimi i termeve “të njëjta” dhe “të ngjashme” në kuptim të kontratave të realizuara në tri vitet e fundit?**

Me LPP, saktësisht në nenin 4 (Përkufizimet) të këtij ligji dhe as me legjisllacionin dytësor të nxjerrë nga KRPP në bazë të autorizimeve që i janë dhënë me këtë ligj nuk jepet ndonjë përkufizim i termeve “të njëjta” dhe “të ngjashme”, megjithatë konform nenit 87, paragrafit 2, nën paragrafit 2.2 të LPP-së, KRPP ofron këtë:

OPINION

Termi “njëjtë (i, e)” mbiemër që ka kuptimin po ai, ose po ajo gjë. Shembull: i njëjti send, i njëjti vend, e njëjta ngjyrë etj.

Termi “ngjashëm (i, e)” mbiemër, ka kuptimin që ngjan shumë me një tjetër. Shembull: në raste (në rrethana) të ngjashme.

Në kuptim të prokurimit publik:

Termi “njëjtë (i, e)” ka kuptimin e një furnizimi, shërbimi a pune të njëjtë (identike) me atë që kërkohet dhe/ose lëndën e kontratës.

Termi “të ngjashme” ka kuptimin e furnizime, shërbimeve, punëve të ngjashme me atë që kërkohet në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.

Shembull: Lënda e Kontratës “Furnizim me mollë”. Nëse AK kërkon si dëshmi “Listën e Kontratave të furnizimeve të njëjta gjatë tri viteve të fundit nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë në vlerë prej minimum.....euro”. Kjo duhet të nënkuptoj se OE duhet të sjellë listën e kontratave të furnizimeve me mollë në vlerën e specifikuar dhe i përjashton OE nga pjesëmarrja që kanë kryer furnizime me pemë dhe/ose perime të tjera. **Prandaj një kërkesë e tillë e kufizon maksimalisht konkurrencën dhe i diskriminon operatorët ekonomik potencial (paragrafët 2 dhe 3 të nenit 7 të LPP-së).**

Në LPP, specifikisht në nenin 69 lidhur me kapacitetet teknike dhe/ose profesionale, referenca përshkruhet si në vijim: “Listën me të cilën specifikohen të gjitha furnizimet kryesore të rëndësishme të operatorit ekonomik të realizuara në tri vitet e shkuara.....” Pra, nuk përmendet asnjëri nga termet “të njëjta” apo “të ngjashme”.

Pavarësisht nga kjo, çdo herë në çdo fazë të aktivitetit të prokurimit AK-të duhet t’i respektojnë parimet themelore të prokurimit publik (transparenca, konkurrenca e lirë, trajtimi i barabartë jo diskriminimi). Prandaj AK-të nuk duhet të specifikojnë kritere të përzgjedhjes me të cilat e kufizojnë konkurrencën dhe i diskriminojnë operatorët ekonomik potencial dhe kështu të mos mund të arrihet vlera për para.

Sa i përket pyetjes së parashtruar nga AK se: “Cilat furnizime, shërbime apo punë konsiderohen të ngjashme...?, KRPP nuk mund të tejkalojë autorizimet që i janë dhënë me ligj dhe të përcaktoj se cilat furnizime, shërbime apo punë konsiderohen të ngjashme me lëndën e kontratës së specifikuar nga AK në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.

Një përcaktim i tillë është kompetencë ekskluzive e AK-së. Pra Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit me ndihmën e njësisë së kërkesës dhe/ose ekspertëve të kësaj fushe mund të përcaktojnë shërbimet e ngjashme. Në kë rast si orientim i mirë për përcaktimin e furnizimeve, shërbimeve apo punëve të ngjashme mund të shërbejnë edhe kodet e përcaktuara në FPP ku aktualisht janë të publikuara 8.323 kode të FPP në Platformën Elektronike të Prokurimit Publik.

Nga kjo që thuhet në këtë OPINION del konstatimi i saktë se aplikimi i kriterit për projekte të realizuara nga natyra e NJËJTË (**ndërtimi i fushës me bari sintetik**) është kufizim i plotë i konkurrencës që e rritë shumë koston e projektit të vet AK-së.

Përpos kësaj, neni 25.17 i RRPP-001/2022 e kërkon decidivisht që gjatë hartimit të dosjeve të tenderit, kriteret duhet të jenë çdo herë drejtpërdrejtë relevante dhe proporcionale me objektin e kontratave. Edhe neni 25.18 i RRPP-001/2022 u kërkon AK-ve që gjatë përcaktimit të kriterëve dhe kërkesave minimale të i kushtojnë rëndësi të veçantë zhvillimit të OE që janë themeluar rishtazi duke vendosur vetëm kriterë të mjaftueshme dhe të arsyeshme. Ja si duken këto dy nene të paraqitura vizualisht nga rregullorja:

25.17 **Të gjitha kërkesat minimale për kualifikim do të jenë drejtpërdrejtë relevante dhe proporcionale për objektin e kontratës në fjalë.**

25.18 Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK do ti kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike. “Të arsyeshme dhe të mjaftueshme” do të nënkuptojnë në lidhje me:

- a. **vlerën e parashikuar të kontratës, dhe**
- b. **përdorim të drejtë të fondeve publike.**

Pra ga krejt kjo që u sqarua më sipër, po shihet se kriteri i vendosur nga AK për posedim të projekteve të realizuara nga natyra e NJËJTË (**ndërtimi i fushës me bari sintetik**) është kufizim shumë i madh i konkurrencës e që nëse nuk largohet do të rezultojë në një konkurrencë shumë të ngushtë dhe në një rritje të madhe të vlerës së kontratës.

**Shkelja e dytë në hartimin e dosjes së tenderit** - AK ka bërë kufizim të konkurrencës edhe me rastin e përcaktimit të kërkesës lidhur me stafin, certifikimet e tyre dhe përvojat tepër të gjata që ka kërkuar. Përpos tjerash ka profesione që nuk lidhen fare me natyrën e punës dhe të projektit, e sidomos kur dihet se kontrata është për realizim të projektit që tashmë është hartuar e jo për projektim. Ja si duken disa nga këto kërkesa:

|  |  |
|--|--|
| <p><b>4. Një (1) Inxhinier i diplomuar apo master të Menaxhimit të Emergjencave të jete I lincesuara si Ekspert I SSHP dhe mbrojtjes nga zjarri Ame,</b></p>   | <p><b>DËSHMI Për Piken 4 dhe 4.1 Stafi duhet të këtë Kontratë të punës valide ose parakontratë për angazhim për këtë projekt. Nëse nga OE prezantohen parakontratë për angazhim për këtë projekt duhet të specifikohet titulli dhe numri i aktivitetit të prokurimit. Po ashtu duhet të dorëzohen edhe diploma, certifikatat e kërkuara, CV e nënshkruar nga punonjësi me të dhëna të sakta, si dhe referencë për punët e mëparshme profesionale</b></p> |
| <p><b>4.1 Një (1) Inxhinier i diplomuar apo master të Makinerisë, së paku 7 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit,</b></p>   | <p><b>DËSHMI Të sillet diploma e shkollës së mesme kopja e certifikatës apo licencës nga institucionet shtetërore. kontratë të punës me OE, apo parakontratë për këtë project.</b></p>   |
| <p><b>5.Një (1) teknik Arkitekturës të jetë i certifikuar apo licencuar për punë ndërtimore nga institucionet shtetërore.</b></p> <p><b>5.1 Një (1) teknik Ndërtimtarisë drejtimi Hidro. Min 15 vite</b></p> |  |

Tek kërkesa 4 AK ka kërkuar **një person me tre certifikime**. Zakonisht këtu kriter do duhej plotësuar me tre persona sepse tepër rrall ka raste kur një person i ka të tre certifikimet në të njëjtën kohë. Kufizimi tjetër është se për Inxhinierin e Menaxhimit të Emergjencave ka kërkuar që certifikimi i tij të jetë ekskluzivisht vetëm nga AME. Kjo bëhet edhe më kufizuese kur dihet se certifikata të tilla lëshon edhe Ministria e Punën dhe Mirqenjes Sociale e po ashtu edhe Ministria e Financave, andaj si të tilla duhet të ndryshohen dhe të lihen në kompetencën e OE që të zgjedhin se nga ku dojnë ta dorëzojnë certifikatën e tillë. Shtu këtu faktin që ka edhe kompani private të licencuara që i ofrojnë certifikimet e tilla e që e bënë edhe më shumë kriterin e tillë si kriter kufizues dhe i përshtatur për një OE të caktuar. Përpos kësaj këto tre certifikime duhet të lihen si mundësi e plotësimit me dy apo tre persona psh, Një Inxhinier i Menaxhimit të emergjencave, një person që është i trajnuar për Siguri dhe Shëndet në Punë e pse jo edhe me një person tjetër që është i certifikuar për mbrojtje nga zjarri. Kjo duhet të lihet si mundësi sidomos kur dihet që jo shpesh hasim persona që kanë tre certifikimet në të njëjtën kohë.

Si kriter kufizues është edhe rasti i kërkesave për teknikun e arkitekturës dhe teknikun e hidros, ku AK ka kërkuar certifikime që tash vështirë se mundet ti ketë dikush për faktin se si të tilla janë tepër të vjetra. Tashmë nuk ka më certifikime për teknik të tillë nga instanca shtetërore e aq më pak që kërkohen për persona me 15 vite përvojë pune. Pse u deshka tekni i Hidros kur asnjë pozicion në paramasë nuk ndërlihet me profesionin e hidros. Pse u dashka tekni i arkitekturës kur detyra kryesore e OE është ekzekutoj projektin e krijuar nga vet AK e jo të bëjë projekte. Projektet i lexon shumë më mirë Inxhinieri i Ndërtimtarisë Konstruktive se sa Tekniku i Arkitektures andaj kërkesa e tillë është ekstrem kufizuese sidomos kur shihet se kërkohet të jetë me certifikim nga instancat shtetërore!. Çfar paradoksi!, Inxhinieri bënë të jetë me diplomë edhe nga Universiteti Privat ndërsa Tekniku i Arkitekturës u dashka nga institucioni shtetëror. Cila është dobia apo nevoja e AK-së dhe cili është qëllimi apo ndikimi pozitiv në projekt që e shtynë AK-në ta vendos si kriter apo më mirë të themi si kufizim?.

Nisur nga krejt kjo që e sqaruar më sipër, kërkojmë nga OSHP që ta detyroj AK-në që të ndryshoj dhe të lejoj mundësi të plotësimit të kriterëve të tilla edhe me certifikime alternative si dhe me përvojë më të vogël të punës. “Ne mendojmë se nuk është ky projekt i NASA-s që të kërkohen certifikime ekzakte që nuk gjejnë fare zbatim në projekt e sidomos kur shihet se kërkohen me gjatësi përvojë 15 vjeçare”!

**Shkelja e tretë në hartimin e dosjes së tenderit** - AK gjithashtu ka bërë shkelje të kriterëve edhe kur ka përcaktuar kërkesën për pajisjet e nevojshme pasi që ka kërkuar pajisje kontraverse njëra me tjetrën dhe të panevojshme për natyrën e punës. Të gjitha pajisjet tek të cilat AK ka bërë kufizim janë me të verdhë dhe po i paraqesim në vazhdim në formë vizuale:

Listë e pajisjeve dhe mekanizmi i nevojshëm shtesë, përveç atyre të përshkruara në dosje

1. Gjenerator për furnizim me rrymë elektrike min. 300 kva;- 1 copë;
2. Kamion me kran me peshë bartëse min 12 ton – 1 copë;
3. Ngjeshëse e Rrugëve max 500kg- 1 copë
4. Kamionetë dubël kabinë me vinç, peshë ngarkuese min 700 kg – 1 copë;
5. Rul hekur me gjemba për ngjeshjen e dheut – peshë maksimale 1.5 ton – 1 copë;
6. Ekskavator mbi 20 ton- 1 copë;
7. Pajisje për lokalizimin e instalimeve nëntokësore të rrymës me pjesë përcjellëse – 1 copë;
8. Makinë për prerjen e asfaltit ose betonit-një- 1 copë;
9. Damber max.3 ton- 1 copë;
10. Eskavator me peshë maksimale 900 kg – 1 copë;

11. Kamion kiper me vinç peshë bartëse max 2 ton, të jetë I pajisur me luge graifer – 1 copë;
12. Cilindër për ngjeshjen që tërhiqet nga ekskavatori -1 cope
13. Kamion i rëndë kiper min. 30 ton- 1 cope
14. Lopatë ngarkuese max. 6 ton- 1 cope
15. Kamion i rëndë kiper min 10 tonë(peshë bartëse min. 24 ton)- 1 cope
16. Betonare për prodhim të betoni ose marrveshje me OE që ka betonare të lincuar
17. Mikser betoni- 3 cope
18. Kompresor 15bar 2 deri 3 ton- 1 cope
19. Aparat saldimit 3 fazor 400Amper me ftohje me uje-2 cope
20. Freze për germim të dheut max 1350kg- 1 cope

Fillimisht tek **pika 1** ka kërkuar gjenerator me minimum **300 KVA** që është i panevojshëm pasi që dihet se organizimin e punës e bënë vet OE dhe ai e gjënë zgjidhjen që të i përshtatet planit dinamik të përfundimit të projektit. Pra kjo nuk nevojitet sidomos kur dihet se ky është projekt pune për punë e jo ofrim shërbimi!

Në **pikën 2** ka kërkuar **Kamion me kran me peshë bartëse min 12 ton – 1 copë**; pa e përcaktuar se pesha bartëse 12 ton është për kranin apo për kamionin. Edhe kamioni por edhe kranin kanë funksionin për bartje të peshës andaj mos përcaktimi i tillë len vend për manipulim.

Në **pikën 3** ka kërkuar ngjeshëse të rrugëve me peshë max 500 kg. edhe pse në paramasë nuk ka fare rrugë. Kjo duhet saktësohet më mirë se për çka bëhet fjalë sepse kështu nuk është shumë e përgjithësuar dhe nuk dihet a është rul apo papuçë goditëse apo çka!.

Në **pikën 4** ka kërkuar **Kamionetë dubël kabinë me vinç, peshë ngarkuese min 700 kg – 1 copë**; ku përpos që i ka ngatërruar funksionet e kamionetës, nuk e ka përcaktuar se kujt i përket pesha ngarkuese e kërkuar, vinçit apo kamionetës. Mandej kamioneta me dubël kabinë kryesisht është për bartjen e punëtorëve dhe si e tillë i përgjigjet kryesisht atyre që bëjnë mirëmbajtjen e rrugëve ndërsa në projektin brenda kantierit nuk ka kurrfarë funksioni.

Kufizimi i kamionetës me vinç që të jetë detyrimisht dubël kabinë është plotësisht i pa arsyeshëm sepse kontraktori ka me krye ndërtim e jo ofrim shërbimesh për transport udhëtarësh. Kamioneta me dubël kabinë i merr 6 persona në bord që në rastin konkret është plotësisht e panevojshme sepse kur i njëjti posedon edhe vinçin e instaluar bëhet paksa edhe e rrezikshme me udhëtua bashkë me persona brenda. Këtë lloj kamionete e posedon vetëm një apo dy kompani në Kosovë e që shihet se AK ua ka përshtatur komplet atyre. Pra si kamionetë me vinç është në rregull si kërkesë por e komplikuar edhe me dubël kabinë tregon se AK po mundohet me çdo kusht ta orientoj tenderin te një OE i caktuar.

Në **pikën 5** ka kërkuar **Rul hekur me gjemba për ngjeshjen e dheut – peshë maksimale 1.5 ton – 1 copë;**. Kufizimi i tillë në këtë peshë është plotësisht i pakuptimtë kur dihet se në hapësirat e njëjta ka me operua edhe kamioni si në pikën 13 që posedon peshën 30 ton dhe Ekskavatori si në pikën 6 me peshë 20 ton.

Në **pikën 6** ka kërkuar **Ekskavator mbi 20 ton– 1 copë** i cili ka peshën e panevojshme aq të madhe sidomos kur shihet se në pikën 10 ka kërkuar eskavator me peshën maksimale 900 kg.

Në **pikën 7** është kërkuar **Pajisje për lokalizimin e instalimeve nëntokësore të rrymës me pjesë përcjellëse – 1 copë;** - kjo pajisje gjendet në përdorim në shumë lloje duke filluar nga pajisja e xhepit e deri tek pajisjet që detektojnë në thellësi deri 10 metra. Mënyra si e ka kërkuar ka lënë shumë mundësi për keq aplikim dhe manipulim me të gjatë vlerësimit të tenderëve. Përpos kësaj, projekti do realizohet në ara(*fushë*) që dihet qartë se nuk ka infrastrukturë nën tokësore në atë vend.

Në **pikën 9** AK ka kërkuar **Damper max. 3 ton– 1 copë;** Kjo pajisje për natyrën e punës është plotësisht e panevojshëm kur dihet se punën e sajë mundet ta kryej edhe një kamion me peshë të ngjashme dhe se po shihet qartë se AK e ka vendosur vetëm sa për të krijuar kufizime të konkurrencës. Mjetet e tilla janë të vjetra dhe shumë pak aplikohen në projekte të tilla.

Në **pikën 10** Është kërkuar **Eskavator me peshë maksimale 900 kg – 1 copë;**. Shtrohet pyetja pse u dashka ky eskavator kaq i vogël kur një i tillë përdoret vetëm nëpër kopshte dhe parqe shumë të vogla. Kërkesa për të është plotësisht e panevojshme. I panevojshëm bëhet sidomos kur në pikë 6 e kemi të kërkuar një eskavator tjetër me peshë mbi 20 ton.

Në **pikën 11** është kërkuar një **Kamion kiper me vinc peshë bartëse max 2 ton, të jetë i pajisjur me luge graifer – 1 copë;** - Ky kamion përpos që është i panevojshëm të jetë kiper me vinç, këtë e bënë edhe më të panevojshëm elementi kur është kërkuar të posedoj lugën graifer. Edhe pesha bartëse e kufizuar për nga maksimumi s'ka asnjë logjikë dhe është kufizim tejet i panevojshëm. Ky lloj i lugës përdoret vetëm tek rregullimi dhe mirëmbajtja e rrugëve e sidomos për bankinat dhe pahijet mirëpo të kërkosh lugë greifer për ndërtimin e fushës sportive, është definitivisht kufizim i palogjikshëm i konkurrencës dhe favorizim i hapur ndaj ndonjë OE të caktuar pasi që s'ka absolutisht nevojë të përdoret ky lloj mjeti në ndërtim të fushës sportive.

Në **pikën 12** kërkohet **Cilindër për ngjeshjen që tërhiqet nga ekskavatori -1 cope – E** kuptojmë që ka kërkuar cilindër për ngjeshje por assesi nuk e kuptoj pse u dashka detyrimisht të jetë cilindër që tërhiqet nga ekskavatori. Kjo lloj pajisjeje nuk parashihet realisht të përdoret në ndërtimet e tilla andaj nuk arrijmë as ta kuptojmë se për çfarë pajisje po bëhet fjalë.

Pajisjet realisht përcaktohen për nga funksioni por nuk duhen assesi të përcaktohen për mënyrën se si e kryejnë funksionin e tillë. Në kohën moderne që ne jetojmë cilindri ngjeshës tërhiqet nga eskavatori vetëm kur është i prishur apo kur nuk ndizet, por nuk e kuptoj si mundet ta kryej punën e tijë një cilindër ngjeshës që e tërheqë eskavatori.

**Në pikën 13 është kërkuar Kamion i rëndë kiper min. 30 ton- 1 cope.** Këtu nuk është e përcaktuar se për cilën peshë bëhet fjalë. Duhet të jetë 30 ton me ngarkesë apo pa ngarkesë. Si i tillë mundet edhe të keq aplikohet dhe keqpërdoret gjatë vlerësimit andaj AK është dashur ta precizoj më mirë dhe më saktë këtë kërkesë.

**Në pikën 15 AK ka kërkuar Kamion i rëndë kiper min 10 tonë (peshë bartëse min. 24 ton)- 1 cope.** Pikërisht kjo tregon se në pikën paraprake AK është dashur të i definoj peshat se për cilën peshë bëhet fjalë. Përpos kësaj se kuptoj as këtu se si mundet të kërkohet një mjet me 34 ton peshë totale, e në anën tjetër të kufizoj konkurrencën me një cilindër ngjeshës 1.5 ton.

**Në pikën 17 janë kërkuar Mikser betoni- 3 copë –** Këtu shtrohet pyetja pse nevojiten kur nëse në OE bënë marrëveshje për furnizim me betonit me një betoniere të licencuar, janë vet ata që e sjellin betonin përmes kamionëve mikser të tyre. Pra kërkesa e tillë duhet realisht të përshtatet edhe për rastet kur ka marrëveshje për betonin.

**Në pikën 18 është kërkuar Kompresor 15bar 2 deri 3 ton– 1 cope –** Në këtë pikë janë dhënë dy kritere që rrinë njëra me tjetrën në mënyrë të zhdrejtë. Funksioni i kompresorit është të ofroj ajër të kompimuar. Tani shtrohet pyetja pse u dashka të jetë pesha e tijë 2 deri 3 ton kur këtë presion të ajrit mundet ta ofroj edhe një kompresor me peshë më të madhe apo më të vogël. Cili është funksioni i peshës së kompresor në këtë rast kur dihet se funksioni i kompresorit është vetëm ofrimi i ajrit nën presion. Nisur nga kjo, po shihet që edhe kriteri i tillë i përshtatet kompresorit adekuat që posedon OE të cilit i është përgatitur ky tender.

**Në pikën 19 është kërkuar Aparat saldimit 3 fazor 400Amper me ftohje me uje-2 cope.** Kjo kërkesë përpos që është kufizuese për faktin që aparatet e saldimit me ftohje me ujë janë të dedikuara vetëm për përdorim në industri, përdorimi i tyre në terren të hapur është edhe i pamundur pasi që nuk ka mundësi të lidhjes së tyre me rrjetin e ujit ftohës. Për qëllimin e përdorimit të bazuar në paramasë, aparatura e tillë nuk nevojitet dhe është plotësisht e panevojshme, e papërdorshme e sidomos kur dihet se tash janë në përdorim aparatet e saldimit me pllakë digjitale dhe s'kanë fare nevojë për ftohje. Mjetet e tilla janë shumë primitive dhe të vjetra të cilat rrallë i gjejmë të përdoren në ndonjë uzinë të vjetër. Si kriter shihet se iu është përshtatur dikujt që i posedon diku në stok dhe se për shumicën apslute të OE është kufizim i panevojshëm i konkurrencës.

**Në pikën 20. Freze per germim te dheut max 1350kg- 1 cope.** AK nuk ka treguar se për çfarë freze bëhet fjalë. Sipas kësaj kërkesa është tepër vështirë të kuptohet se a është frezë që përdoret për kultivimin e tokave apo çfarë lloji është. Ky kriter realisht është vetëm një kufizim i konkurrencës dhe asgjë më shumë sepse punën e sajë e kryejnë pajisjet tjera dhe s'ka fare nevojë për një pajisjet të tillë në projektin në fjalë. Freza të tilla me ngasje vetanake nuk ka në përdorim, prandaj AK nuk ka treguar askund se a është frezë e traktorit apo kush e vë në punë këtë mjet. Bazuar në përshkrimin e punëve tek projekti, kjo len përshtypje se kërkesa në fjalë është vetëm për kufizim konkurrence.

Nga krejt kjo që u tha më lartë, po shihet se komplet kërkesat e tilla që AK i ka vendosur tek FDT janë kufizuese, të pa nevojshëm dhe se po shihet hapur se si të tilla i janë përshtatur një OE të caktuar, vetëm sa edhe emrin që nuk ia kanë publikuar. Nga dosja e tenderit për projektin në fjalë po shihet mirë se AK ka kufizua tej masë konkurrencën duke vendosur kritere në kundërshtim të plotë me ligjin dhe rregulloren e prokurimit dhe me të drejtë konstatojmë se AK ka shkelur plotësisht nenit 7, 27 dhe 69 të LPP-së si dhe ka shkelur edhe nenin 17 dhe 25 të RRPP-001/2022.

**Pretendimi 3.** AK ka shkelur nenin 108/A të LPP-së me rastin e shqyrtimit të Kërkesës për Rishqyrtim pasi që nuk e ka trajtuar atë fare sipas kërkesave të këtij nenin. E themi këtë sidomos kur e shohim vendimin për refuzim që AK e ka publikua ku nuk ka dhënë përgjigje në pretendimet tona por vetëm është lëshuar në kinse “arsyetime” shumë të përgjithësuara dhe pa ofruar asnjë përgjigje ekzakte në vërejtjet që ne ja kemi bërë për secilin kriter kufizues. Mos trajtimi si duhet i Kërkesës për Rishqyrtim përpos që na ka detyruar të i drejtohem edhe OSHP-së me këtë ankesë, ka rezultuar edhe me shkelje të plotë të nenin 108/A të LPP-së nga ana e AK-së.

Bazuar në krejt këtë, kërkojmë nga OSHP që të aprovoj pretendimet tona dhe të i kërkoj AK-së për t’u bërë dosjen e tenderit në përputhje me ligjin, rregulloren dhe praktikën e mira të prokurimit që të ndikojnë pozitivisht edhe në uljen e kostove të vet AK-së. Përpos kësaj e lusim OSHP-në që të i kërkoj AK-së edhe hartimin e dosjes së tenderit duke vendosur kritere jo kufizuese si dhe proporcionale me natyrën dhe madhësinë e projektit në fjalë.

Marrë për bazë krejt këtë që theksuam më lart kërkojmë nga OSHP që të shqyrtoj me kujdesë pretendimet tona dhe të merr:

### **V E N D I M**

**APROVOHET** si e bazuar ankesa e OE “**TREING SH.P.K.**” lidhur me tenderin “**NDERTIMI I FUSHAVE SPORTIVE KOMORAN ,KORRETICË E EPËRME DHE ARLLAT Projekt dyvjeçar**” i iniciuar nga **KOMUNA GLLOGOC**

**ANULOHET** njoftimi për kontratë i **AK - KOMUNA GLLOGOC.**

AK të detyrohet për angazhim serioz në eliminim të kërkesave kufizuese nga dosja e tenderit. Gjithashtu ta detyroj që të rishikohen të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit siç janë referencat për punët e kryera, kërkesat për stafin dhe certifikimet e tyre, e sidomos ato për pajisjet e nevojshme, duke i harmonizuar ato me LPP-në dhe RRPP-001/2022 si dhe duke ia përshtatur natyrës së projektit dhe shpenzimit efikas, efektiv e veçanërisht shpenzimit ekonomik të parasë publike.

## **9. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t’iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

Dëmet materiale që na shkaktohen nëse nuk largohen kriteret e tilla që na e pamundësojnë tenderimin në këtë projekt janë të konsiderueshme në fushën financiare që përbëjnë fitime të munguara, dhe mos mundësi e kompensimit të shpenzimeve përgatitore për këtë kontratë.

## 10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

1. *Njoftimi për Kontratë;*
2. *DOSJA E TENDERIT,*
3. *Pjesa II. PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE*
4. *Përgjigjet në kërkesat për ndryshim të OE*
5. *Dosja e tenderit nga një procedurë e viti të kaluar,*
6. *Procesverbali i hapjes nga një procedurë e ngjashme e vitit të kaluar*
7. *Njoftimi mbi vendimin nga një procedurë e viti të kaluar*
8. *Kërkesa për Rishqyrtim,*
9. *Pezullimi i aktivitetit të prokurimit*
10. *Refuzimi i Kërkesës për Rishqyrtim,*
11. *Dosja e Tenderit FUSHAT SPORTIVE 15.04.2026*
12. *Formulari standard për korrigjimin e gabimeve,*
13. *Opinionin i KRPP-se nr.11 i dates 09.06.2023 per referenca te ngjajshme-njejta*

***Vërejtje: Të gjithë materialin në të cilin i kemi mbështetur pretendimet e gjeni të bashkangjitur ndërsa për më shumë mund të i referoheni edhe materialit të procedurës së prokurimit që ndodhet në e-Prokurimit!***